



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Faq. Br. Str. Page
05	47	1064	1



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Për:	Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
Kopje elektronike:	Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kuvendin e Kosovës Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere në Kuvendin e Kosovës
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2024


Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 20.06.2025
------------	------	------------------

Data	Zyra e Pranimit	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2024. Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.		

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT			
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE			
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION			
Dep.	20	Nr. Prot.	979/25
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot. No.	
Nr. Faq.	18	Data	20.06.2025
Br. Str.		Datum	
Nr. Page.		Date	
PRISHTINË			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të APK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar fushën ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në menaxhimin e pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me një (1) rekomandim të përsëritur. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 68,345€, pasurive jokapitale është 46,128€, si dhe e stoqeve 10,841€.

Çështja B1 - Mosregjistrimi i pasurive dhe paraqitje jo të plotë në shpalosjet e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF)

Gjetja

Bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financiar të Kosovës (SIMFK), ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Gjatë testimeve tona, kemi vërejtur se pagesa prej 565€ nuk është regjistruar në sistemin e-pasuria. Kjo përfshin një mini dome camera (1 copë, 145€) dhe tre mini bullet camera (nga 140€ secila, gjithsej 420€).

Vlen të theksohet që menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e duhura duke regjistruar pasurinë në fillim të vitit 2025.

Shkaku i mosregjistrimit të pasurive ishte një lëshim teknik në mungesë të zyrtarëve dhe operimi me staf mbështetës nga departamentet e tjera.

Ndikimi

Mungesa e regjistrimeve të saktë dhe të plotë ka shkaktuar mungesë të informatave për menaxhmentin duke shkaktuar nën-vlerësim të pasurive, si dhe ka ndikuar në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi B1

Drejtor duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistrat përkatës të pasurive dhe se shpalosja e tyre në PFV të jetë e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	965,660	782,473	760,842	624,341	535,914
Grante Qeveritare - Buxheti	965,660	782,473	760,842	624,341	535,914

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për vlerën 183,187€ ose rreth 19%, bazuar në vendimin e Qeverisë. Në vitin 2024, janë shpenzuar 97% e buxhetit final ose 760,842€,


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	965,660	782,473	760,842	624,341	535,914
Pagat dhe mëditjet	739,694	556,507	556,507	513,851	413,201
Mallrat dhe shërbimet	123,466	123,466	112,698	101,110	112,242
Komunalitë	8,500	8,500	3,120	2,703	3,196
Investimet Kapitale	94,000	94,000	88,518	6,677	7,274

Shpjegimet për ndryshimet në kategorinë e buxhetit janë dhënë si më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me atë fillestar ishte më i ulët për 183,187€, ndërsa shpenzimi ishte 100% e buxhetit final.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte i njëjtë me atë fillestar, kurse shpenzimi ishte 112,698€ apo mbi 91% e buxhetit final.
- Buxheti final për komunalitë ishte i njëjtë me atë fillestar, në vlerë 8,500€, nga të cilat afër 37% janë shpenzuar gjatë vitit.
- Buxheti final për investime kapitale ishte i njëjtë me atë fillestar 94,000€, nga të cilat rreth 94% janë shpenzuar gjatë vitit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Buxheti fillestar dhe final janë zero, që mund të nënkuptojnë se nuk janë parashikuar të hyrat në buxhetin e planifikuar për vitin 2024 por pranimet në 2024 ishin 9,739€. Kjo tregon që shuma e të hyrave të realizuara gjatë vitit 2024, janë si rezultat i fillimit të shqiptimit të dënimeve/gjobave për subjektet deklaruese për zyrtarët publik.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	9,739		
Të hyrat jo tatimore	0	0	9,739		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) ka identifikuar tre (3) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. APK ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, dy (2) nga rekomandimet janë zbatuar me sukses, ndërsa një (1) ende nuk është adresuar. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit të sigurojë se të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistrat përkatës të pasurive të Organizatës Buxhetore.	Nuk janë ndërmarrë veprime	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kamë pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin ;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e këtij rekomandimi.

Ylli Buleshkaj

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Data: 16.05.2025

Nënshkrimi:

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinion i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.